



Programimi në www

Pjesa 7 – CSS (3)

Prof. Asoc. Dr. Ermir Rogova




Hijet e tekstit

- Atributi text-shadow property në CSS3 e lehtëson vendosjen e efektit të hijës në çfarëdo teksti
- Atributi text-shadow ka 4 vlera të cilat përfaqësojnë:
 - Zhvendosjen horizontale të hijes—numrin e pikselave të zhvendosjes së hijes në të djathtë ose të majtë të tekstit. Vlera negative zhvendos hijen e tekstit në të majtë kurse vlera pozitive në të djathtë
 - Zhvendosjen vertikale të hijes- numrin e pikselave të zhvendosjes së hijes mbi ose nën tekst. Vlera negative zhvendos hijen e tekstit mbi kurse vlera pozitive nën tekst
 - Radiusi i mjegullimit (në piksela) të hijes. Vlera 0 do të rezultonte në hije të qartë (pa mjegullim). Sa më e madhe vlera aq më i madh mjegullimi i hijes
 - Ngjyra—përcakton ngjyrën e hijes së tekstit

Shembull

```
<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <meta charset = "utf-8">
    <title>Text Shadow</title>
    <style type = "text/css">
      h1
      {
        text-shadow: -4px 4px 6px dimgrey; /* add shadow */
        font-size: 400%; /* increasing the font size */
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <h1>Text Shadow</h1>
  </body>
</html>
```






Këndet e rrumbullaksuara

- Atributi border-radius mundëson rrumbullaksim të këndeve të një elementi.
- Në shembullin në vijim janë paraqitur dy drejtkëndësha
- Në drejtkëndëshin e parë atributit border-radius i është dhënë vlera 15 piksela
- Në drejtkëndëshin e dytë atributit border-radius i është dhënë vlera 50 piksela
- Çfarëdo vlere më e madhe se gjysma e gjerësisë do të rezultojë në rrumbullaksim të plotë të asaj ane
- Vlerat e radiusit mund të përcaktohen edhe individualisht për secilin kënd duke përdorur border-top-left-radius, border-top-right-radius, border-bottom-left-radius dhe border-bottom-right-radius

Shembull





Shembull


```
<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <meta charset = "utf-8">
    <title>Rounded Corners</title>
    <style type = "text/css">
      div
      {
        border: 3px solid navy; padding: 5px 20px; background: lightcyan;
        width: 200px; text-align: center; margin-bottom: 20px;
        border-radius: 15px; /* adding rounded corners */
      }
      #round2
      {
        border: 3px solid navy; padding: 5px 20px; background: lightcyan;
        width: 200px; text-align: center;
        border-radius: 50px; /* increasing border-radius */
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <div>The border-radius property adds rounded corners to an element.</div>
    <div id = "round2">Increasing the border-radius rounds the corners of the element more.</div>
  </body>
</html>
```



Ngjyra

- CSS3 lejon përcaktimin e ngjyrës edhe në mënyra të tjera përveç formës standarde (forma standarde përfshin emrin e ngjyrës si psh. Aqua ose vlerën heksadecimale të ngjyrës p.sh. #00FFFF)
- RGB (Red, Green, Blue) ose RGBA (Red, Green, Blue, Alpha) na jep kontroll më të madh mbi ngjyrën ekzakte për web faqe
- Vlera për secilën ngjyrë mund të jetë prej 0-255
- Vlera Alpha — paraqet patejdukshmërinë (e kundërta e transparencës) — dhe mund të jetë prej 0.0 (plotësisht transparente) deri 1.0 (plotësisht e patejdukshme)
 - `rgba(255, 0, 0, 0.5)` rezulton në ngjyrë të kuqe gjysëm transparente
- Ekzistojnë mbi 140 emra të ngjyrave në HTML, por janë 16,777,216 ngjyra të ndryshme RGB (256 x 256 x 256) dhe secila me shkallë të ndryshme të transparencës

RGB







Ngjyra

- CSS3 po ashtu lejon shprehjen e ngjyrës duke përdorur standardin HSL (hue, saturation, lightness) ose HSLA (hue, saturation, lightness, alpha)
- Hue është ngjyrë apo nuancë që shprehet me vlera prej 0 deri në 359 që paraqet shkallën këndore në rrotën e ngjyrave
- Ngjyrat në rrotë renditen sipas ngjyrave të ylberit – kuq, portokall, verdhë, gjelbër, kaltër, indigo dhe vjollcë
- Vlera e ngjyrës së kuqe e cila është në fillim të rrotës është 0
- Nuancat e gjelbërta kanë vlera rreth 120 kurse ato të kaltërtat rreth 240
- Saturation (ngopja) — është intensiteti i nuancës—i shprehur në përqindje ku 100% është ngjyrë plotësisht e ngopur kurse 0% është nuancë e hirtë

HSL



Ngjyra

- Lightness—është intensiteti i dritësvi shprehur në përqindje
- Intensiteti 50% është ngjyra e vërtetë
- Vlerat nën 50% e errësojnë ngjyrën deri në të zezë (0%)
- Vlerat mbi 50% ndriqojnë ngjyrën deri në të bardhë (100%)
- Për shembull për të paraqitur të njëjtën ngjyrë sikurse në shembullin paraprak duke përdorur standardin hsla duhet të përdorim vlerat në vijim :
 - `hsla(0, 100%, 50%, 0.5);`






Hijet e kutive

- Në CSS3 mund të hijezojmë çfardo elementi bllok
- Atributi box-shadow ka 4 vlera të cilat përfaqësojnë
 - Zhvendosjen horizontale të hijes – numrin e pikselave të zhvendosjes së hijes në të djathtë ose të majtë të kutisë. Vlera negative zhvendos hijen e kutisë në të majtë kurse vlera pozitive në të djathtë
 - Zhvendosjen vertikale të hijes – numrin e pikselave të zhvendosjes së hijes mbi ose nën kuti. Vlera negative zhvendos hijen e kutisë mbi kurse vlera pozitive nën kuti
 - Radiusi i mjegullimit (në piksela) të hijes. Vlera 0 do të rezultonte në hije të qartë (pa mjegullim). Sa më e madhe vlera aq më i madh mjegullimi i hijes
 - Ngjyra—përcakton ngjyrën e hijes së kutisë

Shembull

```
<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <meta charset = "utf-8">
    <title>Box Shadow</title>
    <style type = "text/css">
      div
      {
        width: 200px;
        height: 200px;
        background-color: plum;
        box-shadow: 25px 25px 50px dimgrey;
        float: left;
        margin-right: 120px;
        margin-top: 40px;
      }
      #box2
      {
        width: 200px;
        height: 200px;
        background-color: plum;
        box-shadow: -25px -25px 50px dimgrey;
      }
      h2
      {
        text-align: center;
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <div><h2>Box Shadow Bottom and Right</h2></div>
    <div id = "box2"><h2>Box Shadow Top and Left</h2></div>
  </body>
</html>
```






Gradientët linear

- Gradientët linearë janë lloj imazhi të cilët gradualisht ndryshojnë nga një ngjyrë në tjetrën në drejtimin horizontal, vertikal ose diagonal
- Ndryshimi mund të ndodhë ndërmjet çfarëdo numri të ngjyrave
- Për këtë mund të specifikojmë edhe pikat ku bëhet ndërrimi që quhen color-stops, dhe shprehen në piksela ose përqindje përgjatë linjës së gradientit



Shembull





Shembull


```
<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <meta charset = "utf-8">
    <title>Linear Gradient</title>
    <style type = "text/css">
      div
      {
        width: 200px; height: 200px; padding: 5px 20px;
        text-align: center; float: left; margin-right: 15px;
      }
      #vertical
      {
        border: 3px solid navy;
        background: linear-gradient(to bottom, white, steelblue, navy);
      }
      #horizontal
      {
        border: 3px solid orange;
        background: linear-gradient(to right, white 15%, yellow 50%, orange 75%);
      }
      #diagonal
      {
        border: 3px solid purple;
        background: linear-gradient(to bottom right, white 15%, plum 50%, purple 75%);
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <div id = "vertical"><h2>Vertical Linear Gradient</h2></div>
    <div id = "horizontal"><h2>Horizontal Linear Gradient</h2></div>
    <div id = "diagonal"><h2>Diagonal Linear Gradient</h2></div>
  </body>
</html>
```




Gradientët Radial

- Gradientët radial janë të ngjajëm me gradientët linearë por aty ngjyra ndryshon gradualisht në formë të rathëve koncentrik prej qendrës kah skajet
- Në shembullin në vijim atributi radial-gradient property ka 3 vlera
- E para është pozita e fillimit të gradientit radial – në këtë rast qendra (center) e katrorit. Vlerat tjera të mundshme për pozitë janë top, bottom, left dhe right me kombinime
- E dyta është ngjyra fillestare (e verdhë)
- Dhe e treta është ngjyra përfundimtare (e kuqe)

Shembull



```

<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <meta charset = "utf-8">
    <title>Radial Gradient</title>
    <style type = "text/css">
      div
      {
        width: 200px;
        height: 200px;
        padding: 5px;
        text-align: center;
        background: radial-gradient(at center, yellow, red);
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <div><h2>Radial Gradient</h2></div>
  </body>
</html>

```



Prefikset e prodhuesëve

Vendor prefix	Browsers
-ms-	Internet Explorer
-moz-	Mozilla-based browsers, including Firefox
-o-	Opera and Opera Mobile
-webkit-	WebKit-based browsers, including Google Chrome, Safari (and Safari on the iPhone) and Android


- Kur punojmë me CSS3 shpesh hasim në tipare të cilat nuk janë finalizuar ende
- Shumë prej shfletuesëve kanë filluar implementimin e këtyre tipareve ende pa u bërë finalizimi
- Në atë rast duhet të specifikohet mënyra e shënimit për secilin grup të shfletuesëve (WebKit, Firefox dhe sintaksë standarde CSS3)



Konturimi i tekstit (text stroke)

- Atributi `-webkit-text-stroke` është një atribut jo standard për shfletuesit e bazuar në WebKit i cili n'a lejon që tekstit t'i shtojmë konturë
- Shembulli në vijim paraqet tekst me ngjyrë të kaltër të hapur të cilit i është shtuar kontura
- Atributi `-webkit-text-stroke` ka dy vlera—trashësia e konturës (2px) dhe ngjyra e konturës (black)
- Teksti është rritur 500% për të dalluar më mirë konturën

Shembull



```
<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <meta charset = "utf-8">
    <title>Text Stroke</title>
    <style type = "text/css">
      h1
      {
        color: lightcyan;
        -webkit-text-stroke: 2px black; /* vendor prefix */
        font-size: 500%; /* increasing the font size */
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <h1>Text stroke</h1>
  </body>
</html>
```




Sfondet e shumta

- CSS3 lejon përdorimin e sfodeve (background) të shumta në një element (shembulli në vijim)
- Stili fillon me vendosjen e dy imazheve logo.png dhe ocean.png
- Pastaj specifikohet vendndodhja e secilit imazh duke përdorur atributin background-position
- Vlerat që ndahen me presje korrespondojnë me renditjen e emrave të imazheve
- Vlera e parë —bottom right—vendos imazhin e parë (logo.png) në këndin e djathtë të poshtëm
- Vlera e dytë —100% center—vendos në qendër imazhin e dytë.



Shembull



Shembull

```
<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <meta charset = "utf-8">
    <title>Multiple Backgrounds</title>
    <style type = "text/css">
      div.background
      {
        background-image: url(logo.png), url(ocean.png);
        background-position: bottom right, 100% center;
        background-origin: border-box, content-box;
        background-repeat: no-repeat, repeat;
      }
      div.content
      {
        padding: 10px 15px;
        color: white;
        font-size: 150%;
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <div class = "background">
    <div class = "content">
      <p>Deitel & Associates, Inc., is an internationally recognized authoring and corporate training organization. The company offers instructor-led courses delivered at client sites worldwide on programming languages and other software topics such as C++, Visual C++&reg;</sup>, C, Java&trade;, C#<sup>&reg;</sup>, Visual Basic<sup>&reg;</sup>, Objective-C<sup>&reg;</sup>, XML<sup>&reg;</sup>, Python<sup>&reg;</sup>, JavaScript, object technology, Internet and web programming, and Android and iPhone app development.</p>
    </div></div>
  </body>
</html>
```





Reflektimet

- Shembulli në vijim tregon si një imazhi ti shtohet reflektimi duke përdorur atributin -webkit-box-reflect
- Ky është atribut jostandard i cili për momentin funksionon vetëm në shfletues të bazuar në webkit
- Vlera e parë e atributit -webkit-box-reflect është drejtimi i reflektimit, i cili mund të jetë above, below, left, or right (mbi, nën, majtas, djathtas)
- Vlera e dytë është zhvendosja, e cila përcakton hapsirën ndërmjet imazhit dhe reflektimit
- Optionale është specifikimi i gradientit që i aplikohet reflektimit
- Gradienti në këtë rast detyron reflektimet të veniten (fade)

Shembull

```
<!DOCTYPE html>
<html>
  <head>
    <style>
      img {
        -webkit-box-reflect: below 0px linear-
gradient(to bottom, rgba(0,0,0,0.0), rgba(0,0,0,0.4));
      }
    </style>
  </head>
  <body>
    <h1>CSS Image Reflection</h1>
    <p>Show the reflection with gradient (to make a
fade-out effect):</p>
    
  </body>
</html>
```





Pyetje???